



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
DREJTORIA E ARSIMIT RINISË DHE SPORTIT

Nr 6637/5 prot

Kamëz, më 31.7.2025

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

**SHPLLJE E VENDIT VAKANT PËR POZICIONIN DREJTUES TË KOPSHTIT NR.21
"UNIVERS", BASHKIA KAMËZ .**

Mbështetur në Ligjin nr.139/2015 “për Vetëqeverisjen Vendore”; në Ligjin nr.48/2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”; në Udhëzimin nr.22 datë 13.11.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për emërimin, uljen në detyrë, pezullimin dhe shkarkimin e drejtorit dhe nëndrejtorit të institucionit publik arsimor parauniversitar, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik Arsimor Parauniversitar” ;

Drejtorja e Arsimit, Rinisë dhe Sportit, institucion në varësi të Bashkisë Kamëz, shpall vendin vakant për pozicionin e Drejtuesit Kopshti nr.21 "Univers" Laknas , Bashkia Kamëz .

Kandidati për drejtor i institucionit publik të arsimit parashkollor duhet:

1. Të zotërojë arsimim si mësues sipas përcaktimeve në nenin 57, të ligjit nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar ;
2. Të ketë përvojë pune si mësues;
3. Të ketë të paktën kategorinë “Mësues i Kualifikuar” me vlerësim jo më pak se “Mirë” në kualifikimin e fundit;
4. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;

Çdo kandidat duhet të dorëzojë **me postë** pranë Drejtorisë së Arsimit, Rinisë dhe Sportit dokumentacionin e mëposhtëm, **jo më vonë se 10 ditë pas shpalljes së këtij njoftimi:**

1. CV-në dhe kopjet e njehsuara me origjinalin të dokumenteve që dëshmojnë pohimet në të. (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr.1 të Udhëzimit nr.22 datë 13.11.2023)
2. Kopjen e njehsuar me origjinalin të librezës së punës.
3. Kopjen e dokumentit të identitetit (ID).
4. Çertifikatën e trajnimit për drejtues të institucionit arsimor parauniversitar ose vërtetimin që është në proces trajnimi, (nëse e disponon).
5. Vërtetimin nga institucioni ku punon, që nuk ka masë disiplinore në fuqi

6. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr 2 të Udhëzimit nr.22 datë 13.11.2023)
7. Tabelën me të dhënat për aplikantin (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr 4 të Udhëzimit nr.22 datë 13.11.2023)
8. Deklaratën e konfliktit të interesit .(sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr 3 të Udhëzimit nr.22 datë 213.11.2023)

Dorëzimi i dokumentacionit do të kryhet **me postë** për Drejtorinë e Arsimit, Rinisë dhe Sportit, në Bashkinë Kamëz **deri më 15.08.2025**

Shënim: Tabela e vlerësimit për kandidatin për drejtor të Arsimit Parashkollor do të bëhet sipas Shtojca 5, Udhëzimi nr.22 datë 13.11.2023

P/

DREJTOR

Aferdita Zefi

Romina Kozì



